

Nr. 2894/2 Prot.

Datë 17.04 2025

Nr. 6785/ Prot.

Datë 18.4 2025

U D H Ë Z I M

Nr. 16, datë 17.04.2025

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 28.3.2025 “PËR PROCEDURAT
DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË
DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR MASAT MBËSHTETËSE PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025” dhe të VKM nr. 150, datë 6.3.2025, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 14, datë 28.3.2025 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për vitin 2025”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun VIII, “Kriteret, dokumentacioni dhe procedura për masën 8: mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi”:
 - a. pika 6, pjesa “Kriteret dhe normativat e përfitimit”, ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“6. Çdo subjekt përfitues duhet të provojë aktivitetin bujqësor për të cilin aplikon, duke paraqitur:

 - faturë blerje për një nga imputet si material mbjellës (farëra ose fidanë) / plehra kimike / pesticide, ose
 - faturë për shitjen e prodhimit.

Faturat mund të ngarkohen në sistem në momentin e aplikimit, ose mund të dorëzohen fizikisht në ambjentet e përcaktuara nga ky udhëzim në Aneksin nr.1, (AREB, Agropika) ose në zyrat qendrore të AZHBR fizikisht apo me postë, deri para pagesës apo para kontrollit (për subjektet që mund të kontrollohen para pagesës).”
 - b. pika 7, pjesa “Aplikimi për mbështetje për naftën për bujqësinë”, ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

“7. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në sistem është në varësi të statusit të pronësisë apo përdorimit të tokës bujqësore për të cilën aplikohet dhe statusit të regjistrimit të saj në ASHK. Në mënyrë të përmblodhur, dokumentacioni i kërkuar sipas skenarëve të ndryshëm, është si më poshtë:

Skenari	Dokumentacioni i skanuar që duhet të ngarkohet nga aplikuesi
Aplikanti e ka në pronësi tokën bujqësore (në emër të tij) dhe ka marrë certifikatën e pronësisë.	Certifikatën e pronësisë shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese
Aplikanti ka AMTP për tokën bujqësore të lëshuar në emër të tij si përfaqësues i familjes bujqësore.	AMTP
Aplikanti është anëtar i familjes bujqësore që ka marrë tokën në pronësi.	AMTP Certifikatë familjare e gjendjes më 1.8.1991 Marrëveshje dakordësie e shumicës së anëtarëve të familjes bujqësore në gjendjen aktuale, në lidhje me punimin/përdorimin e tokës nga aplikuesi.
Aplikanti e ka marrë tokën bujqësore me qira ose në përdorim.	Kontratë qiraje, kontratë huapërdorjeje ose dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve (shoqëruar me dokumentat përkatës të pronësisë).

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ



MINISTRI I FINANCËVE

PETRIK MALAJ

